BASHKIA MA[illegible]
Zyra e Protokollit
Nr. 885 Prot............
Date 15.02.24 Nenshkrimi
J. Kalem

-Tij A. Vreshtas
- STIRP
dt 15.02.2024

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM LEZHË**

Nr.387/655 Akti Lezhë, më 13.02.2024

**Njoftim me shpallje**

Pranë Gjykatës e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë ka vendosur "Për njoftimin e kërkesëspadisë dhe akteve të tjera palës së paditur Bledi Adri me anë të shpalljes publike", rezulton se pranë Gjykatës është duke u gjykuar çështja civile me Nr. 387/655 Regj.Themel, që i përket: *Paditës:* Preng Leti *i paditur Bledi Adri me objekt: "heqje kujdestarie"*

Gjykata konform neneve 133/a dhe 133/b të K.Pr.Civile, parashikimit: "*1. Njoftimi me shpallje publike kryhet me anë të afishimit të tij në gjykatën e vendit ku do të gjykohet mosmarrëveshja, në vendin 65 ku personi të cilit i drejtohet njoftimi ka vendbanimin ose në vendqëndrimin e tij, si edhe në njësinë administrative në të cilën ka vendbanimin ose vendqëndrimin..*", vendosi të njoftojë me shpallje palet e paditur:

***- Bledi Adri, I biri I Bajram dhe Nesibelindur ne Podgorie, Korçe, banuese në Kungulli, 02520031, Nd.10, H.1, Vreshtas, Podgorie, Maliq, Korçe., të njoftohet për lëshimin e deklaratës së mbrojtjes, jo më vonë se 20 ditë nga njoftimit së kërkesëpadisë dhe akteve shoqëruese me anë të shpalljes publike***. Bashkë me deklaratën e mbrojtjes duhet të depozitoni provat në formën e kërkuar nga ligji. Gjykata informon të padituirn në lidhje me mundësinë për të kërkuar ndihmë ligjore dhe detyrimin të informoni gjykatën për çdo ndryshim të mëvonshëm të adresës dhe të të dhënave të kontaktit elektronik për vete ose përfaqësuesin, listen e personave që dëshironi të thërrisni në cilësinë e dëshmitarit, gjeneralitet dhe adresat e tyre, nëse kërkoni provë me dëshmitarë, si dhe faktet që synohen të provohen me ta. Në rast moslëshimi të deklaratës së mbrojtjes sipas nenit 158/7 të Kodit të Procedurës Civile, prapësimet dhe provat që mund të ngrihen ose paraqiten vetëm me kërkesë të palëve, nuk pranohen nga gjykata më pas, nëse nuk janë paraqitur së bashku me deklaratën e mbrojtjes. Pala e paditur mund të marrë kopje të padisë dhe akteve të paraqitura nga pala paditëse, pranë sekretarisë gjyqësore të gjyqtarit të çështjes.
Një kopje e kësaj shpallje afishohet në stendën e Gjykatës e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, një kopje në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, një kopje administrohet në fashikullin gjyqësor, dhe një kopje pranë Bashkia Lezhë. **Njoftimi me shpallje qëndron i afishuar për jo më pak se 20 ditë.**

Gjykata urdhëron Bashkinë Kamez për depozitimin në Gjykatën e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, brenda një afati sa më të shkurtër, të konfirmimit me shkrim për realizimin e afishimit të njoftimit me shpallje ku të konfirmohet qëndrimi jo më pak se 20 ditë në këndin e tyre të njoftimeve. Në rast moszbatimi të këtij detyrimi ligjor, Gjykata do të aplikojë masat ligjore të përcaktuara në K.Pr.Civile.

**Renis Sheshi**

Gjyqtar i Gjykatës Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë
Me urdhër dhe porosi
Veronika Pergjoka

Shpallja publike u afishua në stendën e Gjykatës e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë me datë ___,___, 2024.

**Punonjësi i gjykatës**

Shpallja publike u afishua në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm , Lezhë me datë ___,__, 2024.

**Nëpunësi IT**___________

Nr. 38 Prot